




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



Vendimi nr. 24/22

Data: 10.06.2022

Në mbështetje të paragrafit 12, të nenit 34, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyeratë Publike dhe të nenit 18 dhe nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimit dhe Karrierën në Shërbimin Civil, në cilësinë e Drejtorit të përgjithshëm të Sekretariatit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës - Zyrtarit më të lartë administrativ, nxjerr këtë:

#### VENDIM

#### për emërimin e anëtarit të Komisionit të pranimit në cilësinë e ekspertit të jashtëm

1. z. Mehdi Geci emërohet anëtar i Komisionit të pranimit në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, me mandat 2 (dy) vjeçar në cilësinë e ekspertit të jashtëm në fushën e përzgjedhjes / vlerësimit të burimeve njerëzore.
2. z. Mehdi Geci do ta kryej detyrën e ekspertit të jashtëm në Komisionin e pranimit pavarësisht nga grupi për të cilin zhvillohet konkurrimi.
3. z. Mehdi Geci do të përfitoj një pagë fikse prej 250.00€ (dyqind e pesëdhjetë euro) për çdo procedurë në të cilën merr pjesë.
4. Obligohet Njësia e burimeve njerëzore që të ndërmerrë veprimet për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Ky Vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

#### Arsyetim

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, përmes shpalljes publike të datës 31.05.2022, ka kërkuar ekspert të jashtëm në fushën e përzgjedhjes / vlerësimit të burimeve njerëzore, për ta emëruar anëtar të Komisionit të pranimit.

Në shpalljen publike ka aplikuar vetëm kandidati z. Mehdi Geci, i cili duke i plotësuar në tërësi kriteret e kërkuara u emërua anëtar i Komisionit të pranimit.

#### Vendimi t'i dorëzohet:

- Anëtarit të Komisionit të pranimit - ekspertit të jashtëm,
- Njesisë së burimeve njerëzore dhe
- Arkivës.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të  
Autoritetit Kosovar të Konkurrencës



Sakip Imëri